

Procesverbal

Nga mbledhja e VII - (shtatë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 27.07.2023

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e VII-të,
- 3) Eventuale.

Uran Halimi: Nëse jemi gati, po fillojmë me mbledhjen e VII-të të rregullt për vitin 2023 të KPF. Unë ju falënderoj për prezencën, ju dëshiroj mirëseardhje dhe i përshëndes të gjithë të pranishmit! Ju e keni marrë materialin, po besoj në mënyrë elektronike, po ashtu edhe në kopje fizike, si rend të ditës e kemi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pastaj e kemi shqyrtimin e materialit të seancës së VII-të, edhe në fund e kemi pikën eventuale. Nëse do me e marrë fjalën dikush, përpara se ta qesim në votim këtë rend dite, nëse doni me shtue diçka? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Pikën e parë e kemi miratimin e procesverbalit. A do dikush me shtue diçka në lidhje me procesverbalet? Nëse jo atëherë e hedhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim. Po kalojmë te shqyrtimi i materialit të paraparë për seancën e ardhshme, konkretisht nesër. Si pikë mas procesverbalit është Raporti Financiar i Shpenzimeve Janar-Qershor 2023, e kemi Vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, pika tjetër me radhë është Raporti i Punës së KKS-së për gjashtëmujorin e parë për vitin 2023, Raporti i Auditorit të Jashtëm për PFV për vitin 2022, e kemi Planin për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm, edhe krejt në fund eventuale. Nëse keni diçka për me shtue edhe doni me e marrë fjalën, ju lutem urdhëroni. Nëse jo, atëherë po vazhdojmë. E kemi pikën e dytë, Raporti Financiar i Shpenzimeve Janar-Qershor 2023. A keni diçka me shtue për këtë Raport? Edhe meqenëse e kemi edhe atë kohën e ahengjeve qetash edhe gurbetçitë na kanë ardhë, po e shoh që me duket s'po doni shumë me e zgjat KPF-në. Po më thonë që duhet me e qit në votim secilën prej këtyre pikave. Vazhdojmë me pikën e dytë, kush është pro që kjo pikë të diskutohet nesër në seancë? 6 vota pro, zero kundër, zero abstenim. Është Vendimi

për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023. Kush është pro? I kemi 5 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim. Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, Raporti i Punës së KKSB-së për gjashtëmujorin e parë për vitin 2023. Këtu s'kemi çka diskutojmë, nesër na bien Raportin, në fakt nesër e diskutojmë në Kuvend, kjo nuk votohet po më thotë ky shoku jem. E kemi pikën e pestë, Raporti i Auditorit të Jashtëm për PFV për vitin 2022. Po e lëmë për nesër me diskutue a po? Kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 5 vota pro, zero kundër edhe 1 abstenim. E kemi në pikën e gjashtë Planin për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm. E diskutojmë nesër po besoj edhe këtë. Kush është pro kësaj? Kundër? Abstenim? 5 vota pro, zero kundër edhe 1 abstenim. Tash e kemi pikën e fundit, eventualen. Nëse do dikush me e marrë fjalën. Artani Loshaj e ka fjalën.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Zotni kryetar, ta urojmë edhe ni herë, zyrtarisht haxhin. Edhe s'po due, s'kam desht sot me diskutue shumë, po si njoftim, se s'je konë një muaj ditë këtu, çka ka ndodhë këtu, sa problemet, sa sendet. Veç sa për ni njoftim, e dish ku më dhemb mu, aty në QKMF. Para se me hi aty, po due me e ditë, me na dhonë informacion, qeto manifestimet treditore që i keni bo, 'Opoja Vallëzon', sa ka mund me kushtue shuma e këtij manifestimi. Me e ditë, për shembull, kush e ka marrë, cila OJQ e ka marrë, sa pare e ka marrë, sa pare janë nda, sa janë harxhue. Në qoftë se ka mundësi nesër, se sot je so mysafir, mas ni muaj dite që ke ardhë këtu. Është një problem në QKMF, nashta të kanë kallxue, është mbyllë përkohësisht laboratorit, për herë të parë pas luftës, nga Ministria e Shëndetësisë, nga Inspektoriati, është e ndaluar përkohësisht me punue. Arsyen s'e di. Unë e di, po s'po due me e bot ë madhe, po due me thonë është mirë me marrë informata ti. Është mirë, kryetar, me na kallxue nesër, me pyet sot. Sot jo, se je i papërgatitur edhe drejtori s'të ka ardhë këtu, se e di ai. Pse është mbyllë edhe çka është puna. Unë për afërsisht e di. Qysh është e mundshme, për shembull, krejt QKMF me u bllokue, m'u bo renovimi i QKMF-së. Na kemi punue 14 vjet, po kurrë s'e kemi mbyllë QKMF-në. S'jam nesër hiç, qato deshta me t'i bon ja dy pyetje. Pse është bërë mbyllja e përkohshme e laboratorit, arsyen. Unë e di, por po due me e ditë qytetarët, se ata po më thojnë pyete kryetarin, kryetarin ta nijmë t'u na kallxue ose drejtorin e Shëndetësisë. Pse renovimi i QKMF-së bëhet në mënyrë totale. Për shembull, na përpara kemi punue, për një ditë, dy, tri, pesë, e kemi mbyllë pediatriinë, repartet tjera kanë punuë. Domethënë QKMF është gati e bllokume krejt, veç Urgjenca që punon. Shkojsh në laborator s'punon, shkojsh në ultrazë s'punon, shkojsh në stomatologji s'punon, shkojsh te pediatri nuk punon. Dyert janë çelë, bërllogu është i madh. Është mirë që po boni rindërtim, po me pas kqyr

pjesë-pjesë me e bo. Dy, e treta kryetar, në seancën e fundit nuk ke qenë këtu, kemi lyp staf shtesë për sezon. Është premtue edhe prej juve, është premtue edhe prej drejtorit këtu, po drejtori ato inatet personale që i ka me mu, mos t'i qet me popullatën. Lë që ka dy vetë s'i ka qit, po masdreke nuk kemi edhe qato deri në ora dhjetë, që e keni qit shtesë, qeto ditët nuk punon. A i ka lëshue krejt në pushim, a po i bon për inat, s'e di, domethënë mas orës 15:00 e kie veç një infermier me një mami. Ai na ka premtue neve që edhe mas orës dhjetë, edhe nënkryetari ka qenë këtu, në korrik edhe në gusht mas orës dhjetë do t'i bëjë dy infermierë edhe maminë. Lë që s'e ka bo, po edhe mas orës tre deri në orën dhjetë nuk e ka pru. Domethënë punon veç një infermier me maminë. Unë pata qef me të njoftue ty zyrtarisht këtu. Unë kam pas ty me të ardhë edhe në zyrë. E kam pas një konflikt prapë me drejtorin tënd, z.Behar Brenoli, se kur e kemi pas një mbledhje në QKMF – se masnej po bëhet e madhe, jo ky i opozitës po bën kështu, jo po kërcënon – e kemi pas një mbledhje në QKMF dhe na ka ndalë, mas 24 vjetëve n aka ndalë edhe kujdestarinë. Kujdestaritë e Urjgencës, punëtorëve të Urgjencës, mami, vozitës, infermier dhe mjek, muajin e parë nuk kemi pranue, lë që kemi mangu, mungesë domethënë, prej 18 euro në 7 euro, po hiç nuk na ka lëshue. Domethënë për herë të parë ka ndodhë kjo, që nuk paguhen punëtorët për ndërrimin e natës. Dhe direkt më ka akuzue mu, se ti punosh privat, edhe kemi pas një konflikt kështu verbal edhe – drejtori yt edhe i jemi – Behar Brenoli. Më ka akuzue që punj privat edhe unë po due me të bo me dije, kështu si kryetar, si ma i madh i këtij vendit, nuk është mirë ai me u marrë me jetën time private se, më fal që po të thom, po edhe ti mas orës tre edhe ti si kryetar i Komunës punojsh. Po mirë, po pse këto kërcënime ndaj meje? Në qoftë se ka ai probleme kështu diçka me mu, le t'i zgjidhë jashtë a në mënyrë institucionale. Atij jeta ime private nuk guxon me i interesue. Unë pot ë njoftoj zyrtarisht ty, kam pas me të ardhë edhe në zyrë – jo jo, është shqetësim i jemi ky edhe shqetësim i krejt punëtorëve shëndetësorë, thashë edhe për kujdestaritë edhe për mungesë stafi – ai është t'u marrë edhe me jetën time private. Kështu unë kam pas qef sot me e pas këtu, po ai ikën, ikën, se duhet me ik prej meje. Edhe nesër duhet me u ballafaque ai me mu, është mirë me pas këtu. Një herë për qeto, e mandej të shohim çfarë informata po na japish.

Uran Halimi: Faleminderit, Artan! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Kryetar, mundish me u përgjigj edhe sot, nëse e shohish të nevojshme. Shtesë po lyp Artani.

Artan Loshaj: Kryetar, edhe një pyetje e kam. Ti je mjek qe 40 vite, mas mbylles së laboratorit, një vendim kush e ka marrë, a motra kryesore, a drejtori, a drejtori i Drejtorisë, s’e di, analizat, hemogrami edhe urina të bëhen në laborator. Si është e mundshme një analizë e urinës edhe një hemogram m’i marrë aparaturat me shkue në laborator me punue pacientat. Këtë unë qe 24 vite jam punëtor...Mbyllja e përkohshme e laboratorit të QKMF-së në Dragash nga Ministria e Shëndetësisë, nga Inspektoriati. Është e mbyllet, mos me punue. Zotnitë dhe zonjat, kush me të thonë, s’di kush e udhëheq unë aty atë QKMF, i kanë marrë aparaturat edhe kanë zbrit me aparaturat e hemogramit edhe të urinës, kanë zbrit në barnatore dhe urina dhe hemogrami i pacientëve bëhen në barnatore. 24 vite unë punoj në qat QKMF, nuk kam pa që laboratorit me punue në barnatore. A dini, a jeni në dijeni, a është me dijeninë e juaj apo jo?

Uran Halimi: Me rëndësi me krye punë bre Artan, s’un e lomë na pacientin keq, mos me ia bo analizat. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? S’ka kërkesë tjetër për me e marrë fjalën. Kryetari e ka fjalën.

Bexhet Xheladini: Të nderuar anëtarë të KPF-së! Unë vetëm shkurt do t’u përgjigjem pyetjeve të Artan Loshajt. Sa ka kushtue Festivali? Festivali nuk e di sa ka kushtue, po unë e di sa ka dhënë Komuna. Është bo shpallja publike dhe fituese e shpalljes publike është ShKA ‘Bresana’ dhe ajo ka qenë bartëse e aktiviteteve të Festivalit Ballkanik ‘Opoja Vallëzon’. Drejtor i ShKA-së është Fesal Shaqiri. Në këtë Festival kanë marrë pjesë dhjetë shtete, mbi 300 pjesëmarrës të cilët kanë qenë të vendosur nëpër hotele, shumica dërmuese në Komunën e Dragashit, në ‘Arxhena’ në Brod, në Dragash te ‘La Ruota’, te Guri i Zi dhe pjesa tjetër që nuk ka mund me u sistemue janë sistemue në Prizren. Për tri netë kanë qenë të siguruara të tri hajet edhe fjetja. Komuna për këtë Festival ka nda 32 mijë euro. Ka pas edhe sponzorë, të cilët me angazhimin tim i kemi gjet. Ky Festival sigurisht që do të kushtojë ma shumë, po pjesën tjetër të shpenzimeve do ta mbulojë Ministria e Kulturës. Sa i përket pse është mbyllur laboratorit, mu po më vjen keq që po e them, por ata të cilët i thirrin inspektorët natën, ankohen ditën për mbylljen e laboratorit. Në mënyrë të rrufeshme inspektorët kanë ardhë me e ndalue punën edhe të mjekëve specialistë që i kemi angazhue, po për fat të mirë nuk iu ka ecë. Jo që na e kemi ndalue punën e tyre, po kemi marrë pas asaj edhe gjinekologun. Laboratorit, është pru vendimi nga ana e Inspektoriatit me u mbyllë, mirëpo laboratorit është duke vazhduar punën. Tash, normal, pasi që sipas Inspektoriatit nuk ka kushte me u punue në laborator, është bërë spostimi i kryerjes së shërbimeve në një lokacion tjetër. Për shkak

të prishjes së aparaturës – tash a është bërë prishja si pasojë e faktorit njeri apo për shkaqe teknike, ne atë do ta shikojmë – por pas servisimit të këtyre aparaturave, puna e laboratorit do të vazhdojë normalisht. Por qytetarët janë duke i marrë shërbimet laboratorike në QKMF, u merret qytetarëve materiali për analiza dhe me kerr të QKMF-së dërgohen të punohen në Bresanë edhe në Krushevë, dhe pacientët në ora 13:00 – 13:30 vijnë i marrin rezultatet. Mirëpo, pacienti ka të drejtë edhe të zgjedhë, të shkojë edhe privat. Pse është bërë renovimi total i QKMF-së. Ju e dini, unë kam qenë, kam bo një inspektim të punimeve. Kur ka fillue renovimi, ka qenë një plan i renovimit jo total, por një plan i pjesshëm, të renovohet një pjesë, pastaj pjesa tjetër e kështu me radhë. Unë e kam vërejt që aty kjo nuk është zbatue, por megjithatë shërbimet janë duke u kryer. Unë brenda javës do ta kem prapë një takim, të shkojë ta bëj një kontroll, ndoshta edhe sot dhe nesër në mbledhjen e Asamblesë do të jap një informatë të saktë. Sa i përket stafit shtesë, nuk jam i përgatitur me të dhënë përgjigje. E di që ka nevojë për staf shtesë. Unë e di që i ka lëshue pushim, tash pse i ka lëshue, për atë thashë ka mundësi, unë kam qenë atë ditë me u takue me drejtorin për këtë çështje, por edhe ai vetë ish në pushim, kishte darsëm. Sot ndoshta unë marr informata dhe nesër do të jap përgjigje të saktë. Kujdestaritë është e vërtetë që janë ndalë, unë kam dëgjue masi jam kthye prej Qabes. Është bërë një padrejtësi, nuk e di pse...

Uran Halimi: Kryetar më fal, unë s'besoj që drejtori i Shëndetësisë mundën me i nda pushimet për punëtorët e spitalit. Nuk është kompetencë e tij.

Bexhet Xheladini: Jo, drejtori i Shëndetësisë nuk i jep pushimet, i jep drejtori i QKMF-së, në bashkëpunim me Motrën kryesore. Të kujdestarisë, si kam ardhë ditën e dytë, e kam nënshkrue për dy muaj edhe ato do t'i merrni. Ju kërkoj falje pse ka ndodhë kjo vonesë. Nëse të ka akuzue drejtori i Shëndetësisë pse ti punon privat, ti me ligj ke të drejtë. Ai ka me të kërkue falje. Artan, nëse e zbaton ligjin ti, gjatë punës ku punojsh privat, do të thotë kur nuk je në punë të shtetit dhe ti shkon e punon privat, po duhet të jesh aty punëtor i paraqitur, i lajmëruet, edhe atë kërkush s'munden me ta ndalue. Kërkush s'munden me ta ndalue edhe nëse drejtori të ka thonë, ka gabue edhe duhet me të kërkue falje. Sa i përket laboratorit, që po punohet në barnatore, ata është dashtë me e gjet një zgjidhje për me i krye shërbimet pacientëve edhe punëtorëve shëndetësorë. Tash është ma mirë me ua krye një zgjidhje në laborator, sesa me detyrue pacientin me shkue me i krye analizat privat. Faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Artani e ka kërkuar një minutë replikë.

Artan Loshaj: Kryetar, po ia nisim prej fundit, për drejtorin që ka me kërkuar falje. Ta shohim, faleminderit në qoftë se kërkon falje. Mirë, s'thashë kurgjo, ti thaje duhet me kërkuar falje, faleminderit që...Për në punë që jem, jam me kontratë pune, me kontratë jem – veç ta kryj – me katër orë, se unë e di ligjin, me katër orë. 80 orë i kam në muaj edhe atë ia bie edhe drejtorit edhe kush do me i pa. E dyta, e treta që thaje natën, kush i bon, qysh i bon, tek i bon këto, m'i thittë Inspektoriatin. Ju e dini që Artan Loshaj në sy jua thotë krejtve – nëse keni tendenca te unë, a për të tjerët s'marr përgjegjësi – nuk e bëj këtë. Që thaje bojmë na analiza, bojsh analiza, veç hemogramin e bojsh edhe urinën. Kryetar, qaty punoj o kryetar unë. Ku bëhen tjerat? A kemi kushte na me i çue analizat në Bresanë edhe në Krushevë? Ama qysh, se ti je mjek, s'po due me hi në atë lëmi se unë s'di ma shumë se ti. Qysh mundesh, për shembull, qysh e ndajsh ti plazmën prej... ku kie aparaturë aty, se s'punon aparatura, e kie të mbyllet kryetar. Edhe ti prapë s'po doni me respektue, se me inate po boni, s'po doni me respektue Inspektoriatin, shtetin e RKS-së, shteti ta ka vu ty. Inspektori ta ka vu mos me punue, ti i ke bart ato aparaturat i ke çue me ni vend tjetër. Edhe nuk është vend i përshtatshëm laboratorit – ani a ka mundësi me dalë këtu masnej, me m'dhonë replikë – shtetin nuk po e respektosh, është çfarë është, është inspektor i MSh-së, ai t'i ka vu me të kuqe – qe ku e kom në telefon, nesër në A4 kam me ta qit – 'ndalohet përkohësisht punimi'. I keni marrë dy aparatura i keni qit në laborator poshtë. Keni bo shkelje. Në qoftë se ata s'kanë të drejtë, e ju keni të drejtë, paditni. Përndryshe, nuk është dashtë m'i marrë ato aparaturat. Që thaje vend ma të përshtatshëm s'ka. Përnime s'ka, se krejt QKMF-ja – sot kam me bo video, nesër e lypi kryesues, a ka mundësi me ma lëshue mu këtu këtë, në shërbim tonin, projektorin, edhe m'i pa krejt, dyer e penxhere, material, kompjutera, kretj spitali është çelë, kryetar. Hyjnë pacientat, dalin si në bahçe të babës. Ti thaje shumë mirë që është dashtë me e bo një repart, me vu shirita mos me hi. Shkojsh te doktor Minafiri ku ka punue, doktor Nihati ku ka punue, krejt kompjuterat, aparaturat, krejt jonë çelë, kryetar. Mu po më vjen keq, se e di që shumë sende nuk të njoftojnë, nuk e kom për inat që po foli. Edhe nuk po due m'u bo shumë agresiv, me thonë qe ky i opozitës, qe ku po ha bukë ky, po shkon kundër familjes vet, se unë aty ha bukë, e ruaj familjen. Unë nuk pot ë foli për inate, aty përnime është tmerr, është trishtim çka është t'u ndodhë. Është mirë që po investoni, pediatria nuk punon, shko te pediatri çojte ni fëmijë, s'punon, se s'ka kushte. Shkojsh në Ultrazë, nuk punon, se s'ka kushte, shkojsh në laborator s'ka kushte, shkojsh nëpër

mjekë s'ka kushte. Veç Urgjenca punon, krejt e keni hap lokalit. Nuk keni kushte me punue aty. Masi është mbyllë laboratorit, duhet me e mbyllë total, për 10 ditë ose 20 ditë punon veç Urgjenca. Edhe e njoftosh në Radio Sharr, në Radio Gorë, në Radio Bambus, edhe qytetarët shkojnë veç në Urgjencë me marrë shërbime. Ma mirë është qat laboratorin me e pas pru me ni dhomë të Urgjencës, se që e keni çue në barnatore. Në barnatore ku rri ni bar edhe ku kundërmon ni urinë, është e pakapshme. Për mu si infermier, edhe si asambleist dhe si përfaqësues i popullit, është e palogjikshme m'u bo kjo. Nëse i folish ti për inat, se dikush ditën po ju thirrë, e dikush natën po i thirrë, e mas treve ju po i bini aparaturat, këtë s'e di çka boni se jeni në pushtet, unë s'un mundi me ju thonë mos e boni, ama jeni t'o bo shumë gabime jeni t'o bo. E marr gjakun, kurrë s'më ka ndodhë me marrë gjakun në Dragash, me çue në Krushevë. Merre pacientin, mere autobusin e Komunës, mushi pacientat, mere gjakin edhe puno gjakin qaty. Qetash pacienti vjen e merr gjakin këtu, shkon analiza në Krushevë ose në Bresanë, i thuosh pacientit prit kur të bohet transporti prej atjehit edhe ta bie gjakin prapë e ta bie rezultatit. S'ka ndodhë kurrë, 24 vjet punë i kam unë. Po hallall ju koftë, vazhdoni me të juajën, ju po dini, ju grahni.

Bexhet Xheladini: Unë ta bëj një sqarim të vogël. Na qytetarët pa shërbime s'mujm me i lonë. Këto janë shërbime elementare laboratorike edhe na s'mujm me i lonë. Na i kemi improvizue edhe qytetarët, të gjitha analizat të cilat janë krye para Vendimit të Inspektoriatit, kryen edhe tash, edhe qytetarët i marrin, pacientët i marrin rezultatet në kohë të caktume, të gjitha llojet që janë bo edhe ma herët. Në të njëjtën kohë, do të thotë, kur është hapë laboratorit privat në Dragash, në të njëjtën kohë vjen Vendimi i Inspektoriatit me u mbyllë në Dragash, edhe vjen Vendimi i Inspektoriatit me u mbyllë edhe laboratorit në Blaç. Këtu ka diçka. Gjithashtu, në të njëjtën kohë prishen aparaturat në laboratorit në Dragash, ndërsa personi i cili punon edhe është shërbues aty, punon edhe në laboratorin privat. Do të thotë të gjitha këto populli i di, që këtu diçka ka. Këtu diçka punohet mbrapa shpine edhe punohet për me i orientue pacientët diku tjetër. Vetëm ata të cilët nuk kanë logjikë, nuk e marrin vesh këtë punë, po ata të cilët e kanë një logjikë të shëndoshë, e dinë që këtu, do të thotë në të njëjtën kohë vijnë inspektorat, bëjnë mbylljen e laboratorit në Dragash, në Blaç, edhe në anën tjetër hapet laboratorit privat në Dragash. Na nuk jemi kundër laboratoreve private, pacienti ka të drejtë të zgjedhë ku të dojë me shkue, po na si shtet, si Komunë, jemi të obliguar që të sigurojmë që pacientët të kenë mundësi me i krye shërbimet primare në QKMF – Dragash, edhe atë jemi duke e bërë.

Uran Halimi: Faleminderit shumë! Sa për informacion, kur tha mbyllja e laboratorit në Blaç, ai është laborator privat, e dini ju po besoj. Këto laboratore tjera unë s'i di as ku janë. Sidoqoftë, faleminderit kryetar! Faleminderit për të gjithë ju pjesëmarrës. Përveç këtij debatit, e kemi edhe një kërkesë për ndihmë financiare mjekësore. Na po bësoj që duhet të veprojmë njëjtë, si edhe të gjitha tjerat. Këto ia kemi kaluar vazhdimisht na kryetarit edhe po besoj që edhe këto duhet t'ia kalojmë prapë kryetarit. E kemi një kërkesë nga një qytetar, po besoj është i komunitetit joshumicë edhe është në gjuhën boshnjake që unë s'po e kuptoj, për qato s'po mundi me dhonë ma shumë sqarime. Nuk është cek ndonjë shumë ose diçka, veç flitet për disa terapia, nuk e di për çka është fjala. Domethënë, mjete kryetari ka thënë që s'ka, po na po e kalojmë. Kryetar, ti jepe një përgjigje që s'ka mjete. Na po e kalojmë tek ju, se qashtu kemi veprue edhe me tjerat. Kush është pro që këtë kërkesë ta kalojmë te kryetari? Kush është kundër? Atëherë, kemi 7 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, kalon kjo kërkesë në Zyrën e Kryetarit. Diçka tjetër përveç kësaj nuk kemi. Faleminderit për pjesëmarrjen, e shihemi nesër në seancë!

Kryesuesi i KPF-së

Uran Halimi